

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6905  
E premte, 26 maj 2023  
Çmimi 0.40 €

Grenelli dhe Rama  
pajtohen të punojnë  
më shumë për lirimin  
e Thaçit | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
www.awr-abbruch.de

KOMISIONARI I BASHKIMIT EVROPIAN PËR FQINJËSI DHE ZGJERIM, OLIVER VARHELYI,  
PO QËNDRON PËR VIZITË NË KOSOVË | FAQE 4

## MARRËVESHJA KOSOVË - SERBI, VARHELYI: TË DYJA PALËT T'I ZBATOJNË TË GJITHA OBLIGIMET PA KUSHTE



Komisionari i Bashkimit Evropian për Fqinjësi dhe Zgjerim, Oliver Varhelyi, ka deklaruar të enjten në Prishtinë se marrëveshja e arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

duhet të zbatohet pa kushte. Varhelyi, pas takimit me presidenten Vjosa Osmani, në një konferencë për medie ka theksuar se palët duhet t'i zbatojnë të gjitha

marrëveshjet për të cilat janë marrë vesh. "Të ecim para me zbatimin e marrëveshjes sa më parë dhe të zbatohen pa kushte", ka thënë Varhelyi

### AKTUALE



GRUPI MERCENAR WAGNER FILLON  
TË TËRHIQET NGA BAHMUTI | F. 2

BE-JA LANSON PROGRAMIN PËR  
SUNDIMIN E LIGJIT NË KOSOVË | F. 5

PËRDORIMI I TELEFONIT GJATË  
VOZITJES, POLICIA ME VEPRIME  
TË SHTUARA | F. 7


### EKONOMI



AMBASADORI AMERIKAN: KOSOVA  
KA POTENCIAL PËR ENERGI TË  
RIPËRTËRISHME | F. 8

MINISTRI I BUJQËSISË NËNSHKRUAN  
UDHËZIMIN ADMINISTRATIV  
PËR KAFSHËT SHOQËRUESE | F. 8

### SPORT



PREMTOHET LUFTË E PAKOMPROMIS  
NDAJ SUBSTANCAVE  
TË NDALUARA NË SPORT | F. 14

SHBA-ja  
I KËRKON  
KOSOVËS TA  
THEMELOJË  
ASOCIACIONIN  
| FAQE 3



KATËR KOMUNAT  
ME SHUMICË  
SERBE NË VERI  
UDHËHIQEN NGA  
KRYETARË  
SHQIPTARË | FAQE 5



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Holanda, e gatshme ta nisë trajnimin e pilotëve ukrainas

AMSTERDAM, 25 MAJ - Holanda dëshiron t'i trajnojë pilotët ukrainas për operimin e avionëve luftarakë F-16 sa më shpejt që të jetë e mundur. Kështu u tha në letërën që ministrja holandeze e Mbrojtjes, Kajsa Ollongren, i dërgoi Parlamentit të këtij shteti më 24 maj.

Trajnimit do të koordinohet me Belgjikën, Danimarkën dhe Mbretërinë e Bashkuar, tha Ollongren, duke shtuar se edhe shtetet e tjera mund të bashkohen në këtë proces. Të martën shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se trajnimi i pilotëve ukrainas për përdorimin e avionëve F-16 nuk do ta bënte NATO-n pjesë të konfliktit midis Rusisë dhe Ukrainës.

Një ditë më herët diplomatët e lartë rusë thanë se transferimi i

avionëve F-16 në Ukrainë do të ngrehë pyetje lidhur me rolin që NATO-ja ka në konflikt.

Javën e kaluar presidenti amerikan Joe Biden u pajtua që t'i mbështesë programet e trajnimit për pilotët ukrainas dhe presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, e siguroi presidentin amerikan se avionët F-16 nuk do të përdreshin për sulme brenda territorit rus.

Perëndimi ka thënë se dëshiron ta ndihmojë Ukrainën që ta mposhtë Rusinë, e cila nisi pushtimin e fqinjët të saj në shkurt të vitit të kaluar. Megjithatë, zyrtarët perëndimorë vazhdimisht kanë insistuar se nuk duan të nxisin një konfrontim direkt midis NATO-s, aleancës perëndimore ushtarake të mbështetur nga ShBA-ja, dhe Rusisë.



## Irani teston me sukses raketën balistike me rreze të gjatë veprimi



TEHRAN, 25 MAJ - Irani testoi me sukses një raketë balistike me një rreze të mundshme prej 2 000 kilometrash të enjten, tha media shtetërore, dy ditë pasi shefi i forcave të armatosura të Izraelit ngrii mundësinë e një "veprimi kundër Teheranit" lidhur me programin e tij bërthamor.

Irani, i cili ka një nga programet më të mëdha të raketave në Lindjen e Mesme, thotë se armët e tij janë të afta të arrijnë bazat e armiqve të tyre më të mëdhenj, Izraelit dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës në rajon. Pavarësisht prej kundërshtimit të ShBA-së dhe Evropës, Republika Islamike ka thënë se

do ta zhvillojë më tej programin e saj të raketave "mbrojtëse". "Mesazhi ynë për armiqtë e Iranit është se ne do ta mbrojmë vendin dhe arrijtjet e tij. Mesazhi ynë për miqtë tanë është se ne duam ta ndihmojmë stabilitetin rajonal", tha ministri iranian i Mbrojtjes, Mohammadreza Ashtiani.

Një videoklip i shkurtër u shfaq në televizionin shtetëror të Iranit, ku shihej lëshimi i një versioni të përmirësuar të raketës balistike Khoramshahr 4 të Iranit.

Raketa pretendohet se kishte një rreze veprimi prej 2 000 kilometrash dhe kapacitet për të mbajtur një kokë rakete prej 1

500 kilogramësh.

Sipas agjencisë shtetërore të lajmeve IRNA, raketës me karburant të lëngshëm iu dha emri "Kheibar", duke aluduar në një kështjellë hebreje të pushtuar nga luftëtarët myslimanë gjatë periudhës së hershme të Islamit.

Izraeli, një shtet që Republika Islamike nuk e njeh, e percepton Iranin si një nga kërcënimet kryesore të ekzistencës së tij.

Irani thotë se raketat e tij balistike janë një forcë e rëndësishme parandaluese dhe hakmarrëse kundër Shteteve të Bashkuara, Izraelit dhe kundërshtarëve të tjerë të mundshëm rajonalë.

## Grupi mercenar Wagner fillon të tërhiqet nga Bahmuti

BAHMUT, 25 MAJ - Grupi mercenar rus Wagner ka filluar t'i tërheqë forcat nga qyteti ukrainas Bahmut dhe t'ua dorëzojë pozicionet e tij trupave të rregullta ruse, tha themeluesi i këtij grupi, Yevgeny Prigozhin, në një video të publikuar të enjten më 25 maj. "Ne jemi duke tërhequr njësitë nga Bahmuti. Nga ora 5.00 e mëngjesit të sotëm deri më 1 qershor, shumica e njësisve do të transferohen në kampet në pjesën e pasme. Po ia dorëzojmë pozicionet tona ushtresë", tha ai.

Videoja u publikua në "Telegram" nga shërbimi i tij për media. Në të shihet Prigozhin i veshur me veshje luftarake duke qëndruar pranë një blloku apartamentesh

të dëmtuar nga lufta.

Të shtunën Prigozhin njoftoi kapjen e Bahmutit pas betejës më të gjatë dhe më të përgjakshme të luftës.

Në videon e fundit, Prigozhin, i cili ka kritikuar vazhdimisht publikisht zyrtarë të lartë të mbrojtjes ruse, tha se forcat e tij do të ishin gati të ktheheshin në Bahmut nëse ushtria e rregullt nuk ishte në gjendje ta menaxhonte situatën.

Një ditë më parë ai tha se Wagner ka humbur mbi 20 000 luftëtarë në betejën për kontrollin e qytetit lindor ukrainas të Bahmutit.

Shifra e të vrarëve përbën 20 për qind të 50 000 të dënuarve rusë që ai rekrutoi për luftën në Ukrainë. Ky numër i luftëtarëve të vrarë

vetëm në betejën për Bahmutin është shumë i lartë krahasuar me numrin e ushtarëve që Rusia pretendon se i janë vrarë gjatë luftimeve në Ukrainë, përkatësisht Moskë pretendon se që nga nisja e pushtimit në shkurtin e kaluar, i janë vrarë mbi 6 000 ushtarë.

Rusia ka pretenduar se ka shënuar fitore në Bahmut, por Shtabi i Përgjithshëm i ushtresë ukrainase tha më 24 maj se "luftimet e ashpra" po vazhdojnë brenda Bahmutit.

Bahmuti gjendet në provincën e Donjeckut, që është një prej katër provincave që vitin e kaluar Rusia pretendoi se i ka aneksuar. Këto katër provinca janë pjesërisht në kontrollin e forcave të Moskës.



# ShBA-ja i kërkon Kosovës ta themelojë Asociacionin

PRISHTINË, 25 MAJ - Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është detyrë urgjente e Kosovës. Hovenier ka thënë se Asociacioni është element thelbësor në marrëveshjen për normalizim të raporteve me Serbinë dhe duhet zbatuar për ta siguruar anëtarësimin në strukturat evropiane dhe euroatlantike. "Kosova është zotuar në vitin 2013 për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ne kemi qenë shumë të qartë publikisht për një kohë të gjatë dhe presim të bëhet dhe tani është më urgjente dhe në kohë, sepse është një element fundamental i përgjegjësisë së Kosovës dhe përkushtimit të Kosovës edhe me Marrëveshjen e Brukselit, por edhe kur bëhet fjalë për marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve", ka deklaruar Hovenier në RTV 21. Ai ka theksuar se ShBA-ja dëshiron ta shohë Kosovën duke ecur përpara dhe urgjentisht duke themeluar Asociacionin. "Mendojmë se është koha tani. Jo sepse ne po provojmë të krijojmë probleme për Kosovën, por në të kundërtën. Ne e kemi thënë shumë qartë se rruga e Kosovës për ta përmbushur vizionin e saj si një shtet i integruar plotësisht në strukturat evropiane dhe



euroatlantike bëhet vetëm përmes zbatimit të marrëveshjes bazë dhe aneksit. Kjo nënkupton se detyra urgjente për Kosovën është ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe", ka thënë ai. Kur u pyet për presionin që po i

bëhet Kosovës për ta themeluar Asociacionin, Hovenier tha se ShBA-ja ka vetëm qëllime të mira dhe se dëshiron ta shohë Kosovën shtet "shumëkombësh, sovran, i pavarur dhe demokratik". Ai shtoi se nuk është presion, por inkurajim. "Merrni

parasysh këshillat tona më të mira. Dëshirën tonë për ta ndihmuar Kosovën të krijojë kushte për të arritur këtë vizion të përbashkët", u shpreh Hovenier. Ai bëri me dije se ShBA-ja mirëpret draft-vizionin e kryeministrit Kurti për

Asociacionin, por shtoi se tash duhet hyrë në çështjet praktike të hartimit të statutit që vë në zbatim këtë vizion. "Deri në këtë kohë nuk kam parë më shumë, në kuptimin e një teksti specifik, nga ajo që është bërë publike", ka thënë Hovenieri.

## Basha shfaqet në publik, takon të rinjtë e Tiranës. A po paralajmëron rikthimin në krye të PD-së?



TIRANË, 25 MAJ - Në Shqipëri ish-kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, u rishfaq publikisht të mërkurën, në një takim me të rinjtë në Tiranë, pas pak më shumë se një viti. Në mars të vitit 2022 ai u largua nga drejtimi i forcës kryesore të opozitës pas humbjes në zgjedhjet e pjesshme vendore dhe nën trysinë në rritje të krahut që mbështeste ish-kryeministrin Sali Berisha. PD-ja, e cila në zgjedhjet lokale të 14 majit drejtohej nga Enkelejd Alibeaj, doli shumë keq me vota në këto zgjedhje. Basha, gjatë

bashkëbisedimit me të rinjtë, ka thënë se të gjithë së bashku, pavarësisht prej bindjeve politike, duhet të nisim një ndryshim rrënjësor të sistemit politik në Shqipëri. Basha tha se vendimmarrja duhet të kthehet te qytetarët. "Kënaqësi e veçantë të bashkëbisedoja me të rejtat dhe të rinjtë e kryeqytetit të cilët ndanë me mua arsyet pse shumica e tyre refuzoi me heshtje procesin e fundit zgjedhor. Të gjithë së bashku, pavarësisht prej bindjeve politike, duhet të nisim një ndryshim rrënjësor të

sistemit tonë politik, duke e kthyer vendimmarrjen te qytetarët nëpërmjet listave 100 për qind të hapura, vetingut të politikanëve, kufizimit të mandatit të kryeministrit dhe garantimin e votës së bashkatdhetarëve tanë në mërgim. Një projekt politik konkret, që bashkon shumicën dërrmuese të qytetarëve, të cilët janë gati për një ndryshim të vërtetë", ka shkruar Basha. Kjo është paraqitja e parë publike e Bashës në një aktivitet politik pas një periudhe bukur të gjatë pauze.

## Gjermania i dhuron FSK-së tre kamionë në vlerë 405 mijë euro

PRISHTINË, 25 MAJ - Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të Forcës së Sigurisë së Kosovës të enjten është mbajtur ceremonia e pranimit-dorëzimit të tre kamionëve të autoshkollës në vlerë prej 405 mijë eurosh, donacion nga Gjermania. Në këtë ceremoni ka marrë pjesë ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, i shoqëruar nga inspektori i përgjithshëm i FSK-së, gjeneralmajor Irfete

Spahiu, komandanti i KDS-së, gjeneralbrigade Jeton Dreshaj, si dhe zyrtarë dhe oficerë të MM dhe FSK-së. Përmes këtyre automjeteve lehtësohet zhvillimi i orëve praktike për ushtarakët të cilët janë në proces të licencimit për kategorinë C. Me këtë rast, ministri Mehaj ka falënderuar zëvendësambasadorin e Gjermanisë në Republikën e Kosovës, Matthias Conrad, i cili ka bërë dorëzimin e

donacionit për mbështetjen e vazhdueshme që shteti gjerman ofron për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe shtetin tonë. Ndërsa zëvendësambasadori gjerman, Conrad, ka potencuar se bashkëpunimi i shtetit gjerman vazhdon të jetë i ngushtë me vendin tonë në nivele të shumta ndërshtetërore, sidomos në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.





KOMISIONARI I BASHKIMIT EVROPIAN PËR FQINJËSI DHE ZGJERIM, OLIVER VARHELYI,  
PO QËNDRON PËR VIZITË NË KOSOVË

# Marrëveshja Kosovë - Serbi, Varhelyi: Të dyja palët t'i zbatojnë të gjitha obligimet pa kushte

Komisionari i Bashkimit Evropian për Fqinjësi dhe Zgjerim, Oliver Varhelyi, ka deklaruar të enjten në Prishtinë se marrëveshja e arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të zbatohet pa kushte. Varhelyi, pas takimit me presidenten Vjosa Osmani, në një konferencë për medie ka theksuar se palët duhet t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet për të cilat janë marrë vesh. "Të ecim para me zbatimin e marrëveshjes sa më parë dhe të zbatohen pa kushte", ka thënë Varhelyi

**EPOKA  
ERE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 25 MAJ** - Komisionari i Bashkimit Evropian për Zgjerim dhe Fqinjësi, Oliver Varhelyi, gjatë vizitës së tij në Kosovë të enjten, ka thënë se porosia e qartë që vjen nga Kosova është se vendi është shumë i përkushtuar sa i përket përafrimit me Bashkimin Evropian. "Ju keni treguar zotimin tuaj jo vetëm me fjalë, por edhe duke na bashkuar me qëndrime të qarta sa i përket qëndrimit tonë rreth agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës", ka thënë Varhelyi dhe ka shtuar se Kosovës i duhet ta përshpejtojë zbatimin e reformave në

drejtësi dhe ta përmirësojë zbatimin e kornizave ligjore. Në konferencën e përbashkët për medie me presidenten Vjosa Osmani, komisionari evropian bëri thirrje të shfrytëzohet momentumin dhe të respektohen të gjitha marrëveshjet e arritura me Serbinë. "Mendojmë se është bërë përparim në vitin e kaluar. Tash është e domosdoshme që të dyja palët t'i ofrojnë dhe t'i zbatojnë të gjitha obligimet pa vonesa, sepse duhet ta shfrytëzojmë momentumin. Të ecim para me zbatimin e marrëveshjes sa më parë dhe të zbatohen pa kushte", tha ai, duke cituar konkluzat e Këshillit Evropian, në të cilat

thuhet se të dyja palët nxiten t'i zbatojnë plotësisht dhe pa kushte të gjitha obligimet për të cilat janë zotuar. "Ne nga ana jonë jemi të gatshëm për ta ofruar programin e investimeve, nga i cili do të përfitojnë të gjithë përmes një dialogu të suksesshëm", ka thënë Varhelyi.

Ndërsa presidentja Osmani ka thënë se, ndonëse ka shumë punë për t'u bërë, përkushtimi i Kosovës për t'i ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për t'u afruar me Bashkimin Evropian mbetet i palëkundur. "Në këtë frymë, edhe aplikimi i Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian është një rikonfirmim angazhimi i punës sonë të përditshme. Mbi të gjitha, është rikonfirmim i orientimit tonë euroatlantik", është shprehur presidentja, duke shtuar se vendi është në bashkërendim me BE-në sa i përket mbështetjes së popullit ukrainas dhe vendosjes së sanksioneve kundër Rusisë. Vizita e Varhelyit në Kosovë shënon fillimin e një programi të përbashkët në mes të BE-së dhe Kosovës për forcimin e ligjit dhe luftës kundër krimit të

organizuar dhe korrupsionit.

Komisioni Evropian ka njoftuar se ky program i BE-së, i financuar me 6.5 milionë euro, do të zbatohet në një periudhë kohore prej tre vjetësh me mbështetjen e Francës, Italisë dhe Belgjikës dhe ka për qëllim të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve të institucioneve të Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe do ta forcojë bashkëpunimin ndërkombëtar. Presidentja Osmani ka thënë se Kosova mirëpret iniciativën e tillë. "Në këto përpjekje të përbashkëta BE-ja e ka përkushtimin tonë të plotë, prandaj mirëpresim iniciativën të ngjashme edhe në vazhdim", ka deklaruar ajo.

Sikurse për të gjitha shtetet që janë në procesin e zgjerimit të BE-së, ashtu edhe për Kosovën sundimi i ligjit, reformat në drejtësi dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit janë identifikuar si fushat kryesore që do të merren parasysh nga BE-ja për vlerësimin e gatishmërisë së këtyre shteteve për përparim drejt integritimit evropian. Më 15 dhjetor të vitit 2022

Kosova ka dorëzuar aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Varhelyi është takuar edhe me kryeministrin Albin Kurti.

Para dy ditësh presidentja Osmani, duke folur për procesin e dialogut Kosovës - Serbi, ka theksuar se obligimet e dala nga marrëveshja e Ohrit duhet të zbatohen nga të dyja palët. Ajo ka theksuar se Kosova në këtë proces ka garanci nga ShBA-ja që mos të dilet jashtë kornizave që i përcakton sistemi ynë kushtetues. Osmani ka pohuar se Serbia është duke abuzuar me dialogun në mënyrë që të krijojë kriza të reja në rajonin tonë.

Kosova dhe Serbia më 27 shkurt në Bruksel arritën marrëveshje për normalizim të raporteve, ndërkaq më 18 mars në Ohër u pajtuan për aneksin e zbatimit të saj. Por deri më sot asnjë veprim i zbatimit të saj në praktikë nuk është marrë dhe dialogu ka ngecur. Kosova po kërkon zbatimin e plotë të marrëveshjes, ndërkaq Serbia zbatimin e Asociacionit. Përfaqësuesit ndërkombëtarë po bëjnë thirrje që të dyja palët të ecin përpara në këtë proces.

BETOHEN KRYETARËT E RINJ TË KOMUNAVE NË VERI

## Katër komunat me shumicë serbe në veri udhëhiqen nga kryetarë shqiptarë

Nga 25 maji të katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës udhëhiqen nga kryetarë shqiptarë, të zgjedhur në zgjedhjet e jashtëzakonshme të prillit. Kryetari i Zubin Potokut, i Zveçanit dhe i Leposaviqit kanë bërë betimin të enjten, ndërsa ai i Mitrovicës së Veriut është betuar më 19 maj. Pjesëtarët e komunitetit serb i kanë bojkotuar zgjedhjet e një muaji më parë dhe kanë thënë se nuk do t'i pranojnë rezultatet, përkatësisht kryetarët e rinj

PRISHTINË, 25 MAJ - Kryetarët e rinj, ai i Zubin Potokut, i Zveçanit dhe i Leposaviqit, komuna të banuara me shumicë serbe, kanë bërë të enjten betimin në pozitë të tyre. Të tre ata këta janë zotuar se do të punojnë në të mirë të qytetarëve dhe duke respektuar ligjin. "Uroj që ne, tani e tutje, të jemi në nivel të përgjegjësive më të lartë, duke ua ofruar qytetarëve të komunës së Zubin Potokut, pa asnjë dallim, të gjitha shërbimet. Do të shkojmë në komunë të Zubin Potokut. Të

gjitha objektet që u takojnë qytetarëve dhe komunës do të jenë në posedim të të gjitha dikastereve të drejtuara nga kabineti [i komunës]", tha kryetari i ri i Zubin Potokut, Izmir Zeqiri. Ceremonia e betimit të Zeqirit u zhvillua në objektin e Zyrës Komunale për Komunitete në fshatin Çabër të Zubin Potokut, ndërsa ceremonia për Ilir Pecin në Zveçan u zhvillua në Shkollën Filllore "Isa Boletini" në fshatin Boletin të kësaj komune. "Do të



punoj për të gjithë. Do të jem i barabartë për të gjithë qytetarët e komunës së Zveçanit", tha Peci. Ai tha se nuk e di se kur do të mund të ketë qasje në objektin kryesor të komunës që shfrytëzohet edhe nga strukturat paralele serbe. Betimin e bëri edhe kryetari i ri i Leposaviqit, Lulzim Hetemi, ndërsa ai i Mitrovicës së Veriut, Erden Atiq, e ka bërë më 19 maj. Kryetarët e këtyre katër

komunave me shumicë serbe - që të gjithë shqiptarë - kanë dalë nga zgjedhjet e jashtëzakonshme të prillit, të cilat janë bojkotuar nga komuniteti serb, pas kërkesës së partisë së tij kryesore, Lista Serbe. Qeveria e Kosovës ka paralajmëruar qysh të mërkurën se, për arsye sigurie, kryetari i Zubin Potokut, i Zveçanit dhe i Leposaviqit do të betohen në ndërtesa publike në këto komuna

e jo në kuvendet komunale. Katër komunat në veri kanë qenë pa kryetarë qysh në fillim të nëntorit, kur udhëheqësit e tyre, që të gjithë nga Lista Serbe, kanë dhënë dorëheqje. Institucionet e Kosovës i kanë braktisur edhe zyrtarët e tjerë serbë në veri në shenjë kundërshtimi ndaj një vendimi të qeverisë në Prishtinë për t'i reregjistruar makinat me targa ilegale serbe. Pjesëtarët e komunitetit serb i kanë bojkotuar zgjedhjet e prillit dhe kanë thënë se nuk i pranojnë rezultatet, përkatësisht kryetarët e rinj nga komuniteti shqiptar. Pjesëmarrja në këto zgjedhje ka qenë 3.47 për qind. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se qytetarët serbë janë të frikësuar nga Beogradi zyrtar, por ka theksuar se qeveria e tij synon t'i funksionalizojë institucionet në mënyrë që të garantohen shërbime publike për të gjithë qytetarët.

## BE-ja lanson programin për sundimin e ligjit në Kosovë



PRISHTINË, 25 MAJ - Bashkimi Evropian ka lansuar fillimin e "Programit të BE-së për çështjet e brendshme të Kosovës", një iniciativë e rëndësishme që synon forcimin e përafritimit të sektorëve të punëve të brendshme të Kosovës me standardet dhe praktikën më të mira evropiane. Programi, i financuar nga BE-ja, do të zbatohet nga Ministria e Punëve të Brendshme Italiane në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme Franceze dhe Policinë Federale të Belgjikës. Duke filluar nga 1 marsi 2023, programi i BE-së për Punë të Brendshme në Kosovë do të zbatohet me një buxhet prej 6,5 milionë eurosh dhe kohëzgjatje prej 40 muajsh. Objektivi kryesor i programit është ta promovojë sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore në Kosovë duke lehtësuar ekipet e përbashkëta hetimore dhe duke rritur bashkëpunimin ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit.

Projekti, gjithashtu, do të ofrojë mbështetje operacionale, transferim të aftësive dhe kompetencave për ta përmirësuar efektivitetin e hetimeve në Kosovë. "Ne jemi të kënaqur të lansojmë programin e BE-së për çështjet e brendshme të Kosovës, i cili përfaqëson një moment historik të rëndësishëm në mbështetjen tonë të vazhdueshme për Kosovën. Ky program do të luajë një rol jetik në forcimin e luftës kundër krimit të organizuar, rritjen e bashkëpunimit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit dhe promovimin e sundimit të ligjit", ka thënë Johannes Madsen, shefi i bashkëpunimit të BE-së në Kosovë. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia në Kosovë do të jenë përfutuesit kryesorë të këtij programi i cili do ta ndjekë procesin e reformave madhore të Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke i përafëruar ato me standardet e

BE-së. Në bashkëpunim të ngushtë me Eurojust-in, Europolin dhe agjencitë e tjera përkatëse të zbatimit të ligjit të BE-së, projekti do ta nxisë krijimin e ekipeve të përbashkëta hetimore, duke përmirësuar kapacitetin për hetime ndërkombëtare dhe ndërkufitare. Për më tepër, programi i BE-së për çështjet e brendshme në Kosovë do t'i trajtojë fushat kritike të reformës në Kosovë, duke përfshirë mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe sigurinë kibernetike. Projekti do të ofrojë asistencë për Ministrinë e Punëve të Brendshme për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturës kritike kombëtare dhe evropiane, si dhe mbështetje për zhvillimin e planeve të sigurisë së operatorëve. Gjithashtu, do të bëhen përpjekje për të themeluar një Agjenci të Sigurisë Kibernetike dhe përafërimin e kornizës ligjore dhe institucionale të Kosovës me standardet e BE-së. Programi i BE-së për çështjet e brendshme në Kosovë nënvizon përkushtimin e BE-së dhe shteteve të saj anëtare për të bashkëpunuar me Kosovën për arritjen e rezultateve të prekshme në luftën kundër krimit të organizuar dhe avancimin e sundimit të ligjit. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të nivelit të lartë nga BE-ja, shtetet anëtare dhe institucionet përfutuese, pasqyrojnë vendosmërinë e përbashkët për ta siguruar zbatimin e suksesshëm të programit.



## Grenelli dhe Rama pajtohen të punojnë më shumë për lirin e Thaçit

TIRANË, 25 MAJ (ER) - Ish-emisari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Ballkanin Perëndimor, Richard Grenell, ka njoftuar se ka drekuar me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Grenelli ka thënë se bashkë me Ramën janë pajtuar që të punojnë më shumë që ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të lirohet "sa më shpejt" nga burgu i Hagës. "Kam drekuar me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, një nga aleatët tanë më të mëdhenj në NATO dhe ne ramë dakord që

duhet bërë më shumë për ta çliruar sa më shpejt Hashim Thaçin nga burgu në Hagë. Akuzat kundër tij janë të rreme dhe dëshmitarët thonë se ato janë manipuluar nga Jack Smith", ka shkruar Grenelli në "Twitter". Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë duke u mbajtur në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Procesi gjyqësor ndaj tyre ka filluar në prill të këtij viti. Deri më tani janë dëgjuar shtatë dëshmitarë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS).

## Fillon mbjellja e luleve në hapësirat gjelbëruese në qytetin e Mitrovicës

MITROVICË, 25 MAJ - Drejtorja për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë ka filluar procesin e mbjelljes së luleve dekorative në hapësirat gjelbëruese të qytetit të Mitrovicës. Aksionit për mbjelljen e luleve iu bashkua edhe drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, Granit Tmava, i cili i inkurajon qytetarët të kujdesen maksimalisht për mirëmbajtjen e këtyre hapësirave në mënyrë që ato të duken sa më bukur. "Mitrovica është një qytet i bukur atëherë kur të gjithë bashkëpunojmë në mirëmbajtjen dhe kujdesin ndaj saj", është shprehur Tmava. Komuna e Mitrovicës, respektivisht Drejtorja për Shërbime Publike, këto ditë në vazhdimësi po përkujdeset për pastërtinë publike, mbjelljen e luleve si dhe koshtjen dhe mirëmbajtjen e hapësirave gjelbëruese në pjesë të ndryshme të qytetit.



## Fillon shenjëzimi në të gjitha nyjat kryesore rrugore në Prizren

PRIZREN, 25 MAJ - Ka filluar shenjëzimi horizontal në të gjitha nyjat kryesore rrugore në Prizren. Ky projekt ka filluar në rrethrotullimin e ri dhe do të vazhdojë edhe në fshatra, sipas

nevojës. "Shkarkimi i trafikut dhe siguria e qarkullimit të veturave dhe këmbësorëve në komunikacion është mision", ka thënë kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj.

## Bulliqi dhe Durmishi nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi për projektet infrastrukturore



PODUJEVË, 25 MAJ - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimit me zëvendësministrin e Infrastrukturës, Hysen Durmishi, për financimin e tri projekteve infrastrukturore në Podujevë. Në memorandumun e bashkëpunimit për këtë vit do të financohen projektet: Sanimi dhe rehabilitimi i rrugës së dëmtuar

nga vërshimet në fshatin Pakashticë në vlerë prej 154 000.00 eurosh; zgjerimi, sanimi dhe riasfaltimi i rrugës kryesore në Shamalluk në vlerë prej 186 500.00 eurosh; ndërtimi i rrugës Turuqicë-Herticë në vlerë prej 350 000.00 eurosh. Gjatë nënshkrimit të memorandumit është bërë me dije se realizimi i këtyre projekteve do të fillojë këtë vit

dhe do të vazhdojë edhe në vitin 2024. Kryetari Bulliqi e falënderoi zëvendësministrin Durmishi për mbështetjen e ofruar për realizimin e këtyre projekteve infrastrukturore në komunën e Podujevës si dhe të dyja palët u zotuan për vazhdim të bashkëpunimit edhe në vitet vijuese në projekte të tjera infrastrukturore.

## Nxënësit e komunitetit rom në Gjilan përfundojnë kursin e gjuhës shqipe

GJILAN, 25 MAJ - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka shpërndarë certifikata për komunitetin rom pas përfundimit me sukses të kursit të gjuhës shqipe. Kërkesa për kurs të gjuhës shqipe është iniciuar nga Arianit Sadiku, kryesues i Kuvendit Komunal të Gjilanit dhe Vebi Ramadanit nga Zyra për Komunitete dhe Kthim. Kreu i Gjilanit, Alban Hyseni, pasi i ka përgëzuar nxënësit e komunitetit rom për përfundimin me sukses të këtij kursi, e ka falënderuar OSBE-në për mbështetjen në këtë aspekt, derisa tha se kjo është hera e parë që në Gjilan organizohet një kurs tillë. Në këtë ngjarje ka marrë pjesë edhe drejtori i Zyrës Regjionale të OSBE-së, Igli Totozani, i cili e ka falënderuar kryetarin Hyseni për gatishmërinë e komunës për bashkëpunim dhe për mundësitë që po i ofrohen komunitetit rom.



## Radoica Radomiroviq emërohet zëvendësministër për Komunitete dhe Kthim

Prishtinë, 25 maj - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka emëruar të enjten Radoica Radomiroviq

zëvendësministër për Komunitete dhe Kthim. Me këtë rast, ai e uroi Radomiroviqin për detyrën

dhe i dëshiroi suksese në përmbushjen e përgjegjësisë të reja. Gjatë ditës kryeministri Kurti ka liruar nga detyra e

zëvendësministrit për Komunitete dhe Kthim, Gazmen Salijeviq.



## Shumë e rrezikshme dhe e papranueshme gjuha e Sami Kurteshit ndaj AGK-së

PRISHTINË, 25 MAJ - Anëtari i Vetëvendosje në KQZ, Sami Kurteshi, është përfshirë të mërkurën në një sulm të radhës, të rëndë kundër medieve dhe gazetarëve. Duke komentuar reagimet për emërimin e zonjës Luljeta Aliu për anëtare të Komisionit të Pavarur të Medieve, Kurteshi i ka akuzuar mediet dhe gazetarët se janë pjesë e

“krimit të organizuar politik-ekonomik nën firmën e PLANS”.

Me një gjuhë shumë të rrezikshme dhe absolutisht të papranueshme, zoti Kurteshi ka shkruar se “AGK është pjesë e pandashme e makinës përbaltëse të krimit të organizuar!”. Ai, gjithashtu, i ka akuzuar aktivistët e shoqërisë civile për reagimet duke i

quajtur “ekspert/e” vendor/e, ushujza parazitore të PLANS-it”.

AGK-ja sërish i bën thirrje kryeministrit dhe kryetarit të Vetëvendosjes, Albin Kurti, që të angazhohet për ndalimin e sulmeve të vazhdueshme të eksponentëve të qeverisë dhe partisë së tij, pasi ato ndikojnë në sigurinë e gazetarëve në Kosovë.



## Klinika Infektive, pa terapi për HIV/AIDS


PRISHTINË, 25 MAJ - “Nuk është hera e parë që nuk kemi terapi. Edhe vite më përpara ka ndodhur kjo, sepse ka shumë vjet që jam i infektuar”, thotë për “Radion Evropa e Lirë” një i infektuar me virusin HIV, i cili trajtohet në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

Ka më shumë se dhjetë ditë që ky institucion nuk e ka terapinë që u duhet të prekurve me sëmundjen infektuese HIV/AIDS. “Kjo po na ndikon në shëndet, e për më tepër po e prek edhe gjendjen tonë psikike”, thotë bashkëbiseduesi i REL-it.

Në Kosovë aktualisht janë rreth 80 persona të varur nga terapia për HIV/AIDS. Ata e marrin terapinë në klinikë pa pasur nevojë për t’u shtruar në spital.

Në Klinikën Infektive thonë se porositë për medikamente i kanë bërë me kohë në barnatoren qendrore të QKUK-së, por “ato mungojnë”.

Ministria e Shëndetësisë e Kosovës, e cila është përgjegjëse për furnizimin me barna, konfirmon për REL-in se medikamentet që mungojnë për pacientët me HIV priten të arrijnë gjatë ditë së mërkurë në aeroportin e Prishtinës, pastaj priten të bëhen zhdoganimi dhe shpeditimi.



### Cilat barna mungojnë?

Shefi i repartit për HIV brenda Klinikës Infektive, Murat Mehmeti, thotë se janë së paku dy lloje medikamentesh që mungojnë e që “nuk dihet se kur do të mund të sigurohen”. “Ka më shumë se dhjetë ditë që ne kemi mungesë të barit Dolutegravir

dhe, po ashtu, është një kombinim tjetër i barit Lopinavir/Ritonavir, i cili ka skadim të afatit dhe nuk mund t’ua japim pacientëve”, thotë Mehmeti.

Duke folur për “Radion Evropa e Lirë”, ai shpjegon pasojat që mund t’i shkaktojë trajtimi jo i vazhdueshëm: “Mungesa apo mosmarrja e rregullt e terapisë

rrit mundësinë e zhvillimit të rezistencës së virusit ndaj barnave. Pra, nëse nuk jepet me rregull, përkatësisht nëse ndërpritet marrja e këtyre barnave”.

Alban Gjonbalaj, udhëheqës i Asociacionit Kosovar të Personave me HIV, thotë se ka pranuar disa ankesa për mungesë medikamentesh në

Klinikën Infektive. “Po thonë se [barnat] janë në doganë por, ta them të drejtën, neve nuk na intereson se ku janë barnat. Ato na duhen në klinikë”, thotë ai. Virusi HIV e dëmton sistemin imunitar të personit të prekur, duke e lënë atë të ekspozuar ndaj infeksioneve të rënda. Sipas të dhënave nga Klinika Infektive, vitin e kaluar janë identifikuar 14

raste të reja me HIV/AIDS, kurse këtë vit janë evidentuar edhe shtatë raste të reja. Shumica e të infektuarve janë burra.

Rasti i parë me HIV/AIDS në Kosovë është paraqitur në vitin 1986 dhe që atëherë rreth 50 persona kanë humbur jetën. Kosova radhitet në mesin e vendeve me shkallë më të ulët të HIV/AIDS-it.

## Përdorimi i telefonit gjatë vozitjes, policia me veprime të shtuara

PRISHTINË, 25 MAJ - Në vazhden e angazhimeve policore për ngritjen e masave të sigurisë në trafikun rrugor dhe me qëllim të vetëdijesimit të shoferëve për rreziqet e përdorimit të telefonit gjatë vozitjes, gjatë kësaj jave, në kuadër të Drejtorisë Rajonale e Policisë në Mitrovicën e Jugut, po zhvillohet fushatë me aktivitete dhe masa

shtesë, veçanërisht për pjesëmarrësit në trafik të cilët drejtojnë automjetet duke përdorur telefoni.

Përveç kontrolleve dhe masave ndëshkimore për parandalimin e aksidenteve në trafik, policia për shoferët në trafikun rrugor po shpërndan fletushka me përmbajtje sensibilizues për pasojat dhe rreziqet e

përdorimit të telefonit gjatë vozitjes, ku përmes kësaj fushate synohet të vetëdijesohen pjesëmarrësit në trafik, në veçanti shoferët e automjeteve.

Policia e Kosovës u bën thirrje të gjithë pjesëmarrësve në trafikun rrugor që të kenë kujdes dhe t’u përmbahen rregullave të përcaktuara me Ligjin për Sigurinë në Trafik.



U MBAJT KONFERENCA E PARA-OFERTIMIT PËR ANKANDIN SOLAR 100 MW

# Ambasadori amerikan: Kosova ka potencial për energji të ripërtërishme

Në Prishtinë është mbajtur Konferenca e Para-Ofertimit për Ankandin Solar 100 MW, organizuar me mbështetje të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID Kosovo). Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka theksuar se Kosova ka potencial për energji të ripërtërishme dhe e kanë për obligim ta mbështetin Kosovën. Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka thënë se si institucione janë në proces të finalizimit të Ligjit për Energjitë e Rinovueshme, i cili përfshin praktikat më të mira botërore në industrinë e energjisë së rinovueshme

EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 25 MAJ** - Kryeministri Albin Kurti, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, kanë hapur të enjten Konferencën e Para-Ofertimit për Ankandin Solar 100 MW - të organizuar me mbështetje të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID Kosovo). Ambasador Hovenier ka theksuar se shteti i tij e ka për obligim ta mbështesë Kosovën. "Jam shumë i lumtur dhe ju përgëzoj për nisjen e ankandit të parë, sepse po punojmë për të ardhmen e energjisë. Ky është një hap për t'i përmbushur kërkesat e BE-së për energji të ripërtërishme. Kriza energjetike na tregoi sa është i rëndësishëm furnizimi me rregull. Më vjen shumë mirë që edhe sektori privat është përfshirë në këtë, ngaqë ata janë jetikë në energjinë e ripërtërishme. Andaj i përgëzoj prijësit për proces transparent dhe për bashkëpunim me sektorin privat. Për fat të mirë, Kosova ka potencial për energji të

ripërtërishme. Na vjen mirë që kemi mundësinë t'ju mbështesim dhe këtë e kemi obligim. Falënderoj edhe stafin e mrekullueshëm të USAID-it!", ka deklaruar Hovenier.

Sipas kryeministrit Albin Kurti, ankandi i parë diellor që po pritet të krijohet në Kramovik ka potencial të sigurojë energji elektrike për pothuajse 20 000 familje, projekt ky i cili ua hap rrugën projekteve të mëtejshme të energjisë së rinovueshme në Kosovë. "Kjo pasqyron angazhimin tonë për një agjendë kuptimplote të ndryshimeve klimatike, mirëqenien e qytetarëve tanë dhe kalimin tonë drejt një të ardhmeje të qëndrueshme energjetike. Për më tepër, ne jemi në proces të finalizimit të Ligjit për Energjitë e Rinovueshme, i cili përfshin praktikat më të mira globale në industrinë e energjisë së rinovueshme dhe ofron siguri ligjore dhe rregullatore për investitorët e mundshëm", ka thënë kryeministri.

Ai theksoi se investimi për ankandin e parë diellor përbëhet nga një marrëveshje mbi 200 milionë euro me Korporatën e Sfidës së Mijëvjeçarit për sistemet e ruajtjes së baterive, një



marrëveshje ndërmjet Korporatës sonë Energjetike dhe General Electric për modernizimin e termocentralit "Kosova B", dhe një marrëveshje prej 160 milionë eurosh me Fondin Monetar Ndërkombëtar për të ndërtuar kapacitete të energjisë së rinovueshme. Më tutje, duke përmendur elementët që e bëjnë Kosovën një destinacion tërheqës për investitorët, sikurse afërsia e saj me tregjet evropiane, fuqia punëtore e aftë, dhe një kuadër i fuqishëm rregullator, kryeministri veçoi se synimi i qeverisë është t'i inkurajojë investimet private dhe të krijojë një klimë të favorshme investimi, të cilat edhe janë shtytës kyçë për rritjen ekonomike. Mirënjohjen e tij të thellë kryeministri e shprehu edhe për ambasadorin Hovenier

dhe Qeverinë e ShBA-së, si dhe për Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për mbështetjen e palëkundur në ndihmën e Kosovës për identifikimin dhe promovimin e potencialit të madh të burimeve të ripërtërishme të energjisë. Ai u nda i kënaqur edhe me punën e ministres Rizvanolli dhe ekipin e saj, të cilët kanë mundur të zhvillojnë këtë iniciativë dhe të krijojnë një proces të hapur dhe transparent tenderimi në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ministrja Rizvanolli ka theksuar se përmes konferencës i kanë ftuar të gjithë investitorët potencialë të konkurrojnë me projektet e tyre më inovative e me teknologjitë më të zhvilluara, si dhe për t'i siguruar të gjithë

investitorët potencialë që Qeveria e Republikës së Kosovës do të jetë partnere e besueshme përgjatë gjithë procesit dhe do të garantojë një proces të drejtë dhe transparent.

Ajo e ka falënderuar USAID-in për mbështetje në hartimin e legjislacionit dhe përpilimin e strategjisë. "Pavarësia energjetike është siguri për zhvillim. Do t'i gjenerojmë edhe praktikat e reja. Investimet dhe puna që po bëjmë është garanci për zhvillim edhe të fuqisë punëtore që është e aftë të punojë në këtë sektor. Falënderoj USAID-in për mbështetjen pasi jemi përballur me sfida. Kriza në këtë periudhë na ka dalë në ndihmë dhe ka qenë partneri kryesor në të gjitha hapat tanë në strategji dhe në legjislacion", ka thënë Rizvanolli.

## Ministri i Bujqësisë nënshkruan Udhëzimin Administrativ për kafshët shoqëruese



**PRISHTINË, 25 MAJ** - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka nënshkruar Udhëzimin Administrativ (UA) për kushtet dhe kërkesat teknike që duhen plotësuar nga strehimoret e kafshëve shoqëruese, akt ky ligjor i cili ua përcakton komunave në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, kushtet se si duhet t'i trajtojnë kafshët shoqëruese. "Përmes Udhëzimit Administrativ për kushtet dhe kërkesat teknike që duhen plotësuar nga strehimoret e kafshëve

shoqëruese, krijojmë bazën ligjore e cila ua përcakton komunave në mbarë territorin e Republikës së Kosovës kushtet se si duhet t'i trajtojnë qentë endacakë. Komunitat le t'i përmbushin obligimet ligjore dhe të alokojnë mjete financiare të cilat do ta mundësojnë adresimin e plotë të çështjes së qenve endacakë", ka thënë Peci. Ai ka bërë me dije se ky Udhëzimi Administrativ rregullon këtë fushëveprim. "Krijimin e një programi për kontrollin e qenve endacakë, organizimin e strehimores së

kafshëve që do ta mbështesë zbatimin e planeve lokale të kontrollit të popullatës së qenve dhe maceve, sigurimin e një lokacioni të sigurt për deponimin e trupave të kafshëve të ngordhura nga komunat në mbarë territorin e Republikës së Kosovës. Përmes këtij Udhëzimi Administrativ përcaktohen në detaje veprimet dhe sjelljet ndaj qenve endacakë që nga momenti i kapjes, izolimit, trajtimit, kastrimit, sterilizimit, fazës post-operative, socializimit, adoptimit dhe lëshimit", ka thënë ministri Peci.



# Si të sundoni mbi emocionet tuaja, këshilla e një mbreti-filozof



Nga Kevin DIKINSON

Mark Aureli e sundoi Romën në një kohë të trazuar. Murtaja Antonine e dërrmoi perandorinë. Dy luftëra në kufi dëmtuan rëndë ushtrinë dhe e boshatisën arkën perandorake. Një gjeneral i besuar, Avid Kasi, udhëhoqi një rebelim kundër tij. Dhe në fund vetë Marku pati jo pak probleme shëndetësore, ndërsa djali i tij Komodo ishte një njeri shumë i lig.

Pavarësisht këtyre sfidave, historia e vlerëson lart Mark Aurelin dhe udhëheqjen e tij. Sepse ai shmangu ndarjen e perandorinë, miratoi ligje për të përmirësuar jetën e qytetarëve dhe skllëvërve, dhe madje mund të ketë dërguar një mision diplomatik në Kinë për të krijuar një rrugë tregtare disa shekuj përpara udhëtimit të famshëm të Marko Polos.

Për arritjet e tij, ai konsiderohet i fundit nga Pesë Perandorët e Mirë, dhe një simbol i Epokës së artë të Romës. Po si ia doli vallë? Si çdo figurë historike, përgjigja është e shumëanshme. Sigurisht, një rol të madh luajti përkushtimi i tij personal ndaj arsimit, filozofisë dhe punës së palodhur.

Një element tjetër ishte temperament i tij ndaj politikës dhe ligjit. Por sipas meje, avantazhi i Markut ishte kultivimi i inteligjencës së tij emocionale, dhe aftësia e tij për ta përdorur atë në momentin më kritik. Siç përcaktohet nga Daniel Goleman, inteligjenca emocionale (EI) është “aftësia për të njohur ndjenjat tona dhe ato të tjerëve, për të motivuar veten dhe për të menaxhuar mirë emocionet në vetvete dhe në marrëdhëniet tona”.

Ajo përfshijnë aftësi të tilla si vetëdija, motivimi, vetë-rregullimi emocional dhe ndërgjegjësimi social. Ndërsa është e sigurt se Mark Aureli nuk do të ketë menduar në terma kaq modernë, ai e kuptoi gjithsesi vlerën e aftësive të tilla në aspektin e etikës praktike. Siç vëren Kristofer Xhill, profesor i mendimit të lashtë në Universitetin Ekster: “Vetëkontrolli dhe vetë-reflektimi ishin tipare standarde të praktikës filozofike në atë kohë, dhe metodat e etikës praktike të evoluuar në atë periudhë, i inkurajuan njerëzit të ecin përpara me vetë-përmirësimin e tyre.”

Prania e inteligjencës emocionale tek Marku, është e qartë në menaxhimin që i bëri rebelimit të lartpërmendur. Në vitin 175, Kasi përhap zëra mbi vdekjen e Markut, për të grumbulluar mbështetje në provincat lindore dhe për ta shpallur veten perandor. Në atë kohë, Mark Aureli luftonte në veri, por kur mësoi për kryengritjen, bëri menjëherë paqe me fiset gjermane dhe e ktheu vëmendjen drejt lindjes.

Megjithatë, të dy nuk do të luftonin kurrë, pasi ambiciet mbretërore të Kasit u ndërpreu nga kama e një vrasësi. (Mos e nënvlerësoni rolin që luan fati në histori). Ashtu si shumë monarkë para dhe pas tij, Marku mund të kishte shfrytëzuar rastin për të shtypur armiqtë e tij dhe nënshtruar me dhunë provincat.

Por në vend të kësaj qasjeje, ai tregoi vetëpërmirësim. I fali bashkëpunëtorët e gjeneralit rebel. Në këtë mënyrë tregoi një vetëdije të pabesueshme për një lider të epokës së tij, si dhe një ndërgjegjësim shoqëror për

mënyrën e rinovimit të besnikërisë. Një shembull tjetër është vendimi i tij për të sunduar së bashku me vëllain e tij të birësuar, Lucius Verus.

Kur Senati i dha Markut titullin perandor, mbreti-filozof refuzoi ta pranonte atë nëse Luciusinuk emërohej bashkë-perandor me të. Sipas historianit Frenk Meklin, Marku bëri këtë zgjedhje si një mjet për të “zhdukur mundësinë e një grushti shteti nga klani rival Seionius”

Po si kultivoi ai inteligjencën emocionale? Një nga metodat që përdori ishte ditari, dhe ne e dimë këtë nga fletoret e tij që i mbijetuan kohën atij në formën e “Meditimeve”. Sot ato lexohen shpeshherë si një tekst i rrymës së stoicizmit. Por dëshmitë sugjerojnë se Marku nuk i shkroi për t’u botuar ose mësuar të tjerët. Xhill thotë se ato nuk kanë ndonjë renditje të veçantë. Temat përsëriten shpeshherë, ndërsa në disa raste Marku grupon bashkë citate nga autorë të ndryshëm. Këto dhe shenja të tjera tregojnë se vepra ishte një ditar personal, të cilin e mbante gjatë fushatave të tij ushtarake në Evropë.

Ashtu si shumica e njerëzve, Mark Aureli e kishte të vështirë të ngrihej nga gjumi herët në mëngjes. Por duke u përballur me kohëra të trazura, e kuptoi nevojën për ta bërë zakon këtë gjë. Por përveç eksplorimit të inteligjencës së tij emocionale, ai mund të ketë pasur përfitime shtesë nga zakoni i mbajtjes së ditarit.

Studimet moderne tregojnë se shkrimi ekspresiv, pra ditari, mund të rrisë mirëqenien psiko-fizike të njeriut. Një përmbledhje e hulumtimeve klinik e publikuar në

“Advances in Psychiatric Treatment”, zbuloi se kjo praktikë lidhet me përmirësimin e humorit, një mirëqenie më të madhe psikologjike dhe përmirësim të gjendjes shëndetësore, siç është presioni i ulët i gjakut.

Edhe pse studiuesit nuk mund të përcaktojnë një arsye të saktë për këto përfitime, ata supozojnë se ditari i ndihmon njerëzit të zhvillojnë një narrativë koherente, e cila “i ndihmon në riorganizimin dhe strukturimin e kujtimeve traumatike, duke prodhuar skema të brendshme më përshtatëse”.

Por inteligjenca emocionale nuk ndërtohet brenda një dite. Ju nuk keni nevojë të shkruani ditar për orë të tëra çdo ditë, derisa të keni “Meditimet” tuaja si Mark Aureli. Ekspertët rekomandojnë disa hapa të vegjël gradualë.

Vendosini vetes synimin që të shkruani ditar çdo ditë për 30 ditë, por kufizohuni të shkruani për vetëm 5 minuta maksimumi, apo edhe një fjali të vetme. Kjo strategji mund t’ju ndihmojë të ndërtoni zakonin dhe vulltin. Pas kësaj, mund ta rritni kohën, të themi në 10 minuta ose disa fjali.

Dhe kështu me radhë. Por kini kujdes, sepse vetë-reflektimi mund të ketë edhe anën e tij të errët. Psikologjia organizative Tasha Eurih thotë se përpjekja për të kuptuar pse ndihemi ose veprojmë në një mënyrë të caktuar, mund të na çojë në kuptime të gabuara.

Për shembull, një prind që reflekton mbi një incident, në të cilin i bërtiti fëmijës së tij, mund të supozojë se e bëri këtë sepse ai është një person i keq, në vend se të arrijë në përfundimin se është një njeri i mirë që ka pasur në përgjithësi një javë të keqe në

punë.

Për të shmangur këtë prirje, Eurih rekomandon heqjen dorë nga eksplorimi i pyetjeve emocionale që nisnin me “Pse”, dhe fokusimin më tepër tek pyetjet që nisnin me “Çfarë”.



Për shembull, në vend se të nisni një shënim në ditar me pyetjen “Pse i bërtita fëmijës tim?”, do të ishte më mirë të pyesnit “Cila ishte situata që ju bëri të zemëroheni kaq shumë me fëmijën tuaj? Çfarë mund të bëni për të parandaluar ndodhjen e një situatë të ngjashme në të ardhmen?”.

Një mënyrë tjetër për të marrë një distancë emocionale nga një situatë e caktuar, dhe që ditari të mos përforcojë emocionet negative, është të përfshihen në biseda të distancuara me veten. Biseda me vetveten në distancë është kur i flisni (ose shkruani) vetes sikur po flisni (ose shkruani) një personi tjetër.

Në një studim të kryer nga psikologu Etan Kros, pjesëmarrësve iu kërkua të shkruanin mbi frikën dhe shqetësimet e tyre përpara se të mbanin një fjalim publik. Njëri grup u udhëzua të shkruante duke përdorur “unë” në vetën e parë, ndërsa grupi tjetër shkroi duke përdorur “ju” në vetën e dytë.

Rezultatet e treguan se pjesëmarrësit në grupin e dytë, përjetuan më pak siklet dhe menduan më pak për performancat e tyre më pas. Këtë praktikë e përdori dikur edhe Mark Aureli. Pjesa më e madhe e “Meditimeve” është shkruar në vetën e dytë.

Marrë me shkurtime nga  
“Big Think” – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Premtohet luftë e pakompromis ndaj substancave të ndaluara në sport



PRISHTINË, 25 MAJ - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK), në bashkëpunim me Agjencinë për Anti-Doping KosADA, po zhvillon seminarin për zyrtarë të kontrollit të dopingut. Në këtë seminar që do të zgjasë tri ditë do të ligjërohet para zyrtarëve të antidopingut për mënyrën se si duhet të luftohet ky fenomen shqetësues në sport në nivel botëror.

Zëvendësministria e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Daulina Osmani, në hapje të këtij seminari deklaroi se kjo dukuri negative në sport duhet dhe do të luftohet edhe në sportin e Kosovës ashtu siç bëhet në të gjithë botën. "Duke e ditur qëllimin tonë të përbashkët për zhvillim të sportit përbrenda vendit fillimisht, pastaj edhe për konsolidim të rezultateve dhe të arriturve në arenën ndërkombëtare, padyshim që qëllimi ynë është edhe që këto

arritje, këtë zhvillim, ta bëjmë në një ambient më të sigurt, me një qeverisje më të mirë sportive duke i mësuar të rinjtë dhe të rejtat tona çfarë është Fair Play, cilat janë ato dukuri negative të cilat mund t'i hasin gjatë zhvillimit të karrierës së tyre siç është anti-doping, një ndër kërcënuesit më të mëdhenj të sportit në nivel global. Tashmë po sigurohemi që një gjë e tillë do të luftohet edhe përbrenda vendit në përputhje me standardet dhe rregullat ndërkombëtare", ka thënë Osmani.

Luftimin e kësaj dukurie negative e ka kërkuar dhe e ka mbështetur edhe presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi. Ai deklaroi se qëllimi i përbashkët i KOK-ut dhe MKRS-së është që të sigurohet integriteti i sistemit sportiv dhe barazia në garat sportive. "KOK-u është i përkushtuar që komuniteti ynë i

sportit të edukohet dhe të jetë i vetëdijshëm për rregullat e antidopingut në mënyrë që sportistët të jenë të pastër para sfidave që i presin në karrierën e tyre. Qëllimi ynë i përbashkët me Ministrinë për Kulturë, Rinie e Sport, KosADA-në, por edhe me federatat sportive, është fuqizimi i integritetit të sistemit sportiv, kujdesi ndaj shëndetit të sportistëve, sigurimi i drejtësisë dhe mundësive të barabarta në garat sportive. Deri më tani, në garat ndërkombëtare, krahas sukseseve që kemi shënuar, si me fitimin e tri medaljeve të arta olimpikë, shumë medaljeve botërore e evropiane, kemi treguar kulturë të lartë të edukimit si për sjelljet tona para zyrtarëve të antidopingut, por edhe në rezultatet e testeve", ka thënë Krasniqi.

Në këtë seminar treditor do të ligjërojnë ligjërues nga Turqia, Sllovenia si dhe ligjërues vendorë.

## SHKURT

### Bien çmimet e biletave për finalen Gjilani - Prishtina

Kanë ndryshuar çmimet e biletave për ndeshjen finale Gjilani - Prishtina në kuadër të Kupës së Kosovës në Futboll. Gazeta "Engima" raporton se çmimi i biletave në jug dhe veri do të jenë nga 2 euro, në lindje ato do të kushtojnë 3 euro, ndërsa në perëndim do të kushtojnë 5 euro. Gjilani dhe Prishtina takohen më 5 qershor në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë për finalen e Kupës së Kosovës. Takimi fillon në orën 18:00.

### Galatasaray i interesuar për ta blerë Rashicën

Drejtuesit e Galatasarayt kanë hartuar një plan të ri për edicionin e ardhshëm dhe pjesë të planit e shohin edhe yllin e Kosovës, Milot Rashica. Galatasaray është në garë për titull të kampionit në Turqi dhe në rast të shpalljes kampione, Galata siguron pjesëmarrjen në fazën e parë kualifikuese të Ligës së Kampionëve për edicionin e ardhshëm. Trajneri Okan Buruk ka kërkuar që Rashica dhe Mauro Icardi të mbesin pjesë e Galatasarayt, derisa ish-anëtari i Vushtrisë ka shprehur dëshirën të qëndrojë edhe më gjatë në klubin turk. Në ndeshjet e sezonit aktual, 26-vjeçari ka shënuar gjashtë gola dhe ka kontribuar me shtatë asistime në 34 paraqitje. Me klubin anglez ka kontratë deri në qershor të vitit 2025.

### 2 Korriku për herë të gjashtë radhazi shpallet kampion në Ligën U17

Skuadra e 2 Korrikut vazhdon të dominojë në grupmoshën nën 17 vjeç në futbollin tonë. Skuadra kryeqytetase u shpall kampione në Ligën U17, duke marrë titullin e gjashtë radhazi në këtë kompeticion. Ceremonia zyrtare e shpalljes së kampionëve u mbajt pas fitores që 2 Korriku e arriti kundër Trepçës me rezultatin 3-1. Medaljet dhe trofeu i kampionëve u dhanë nga anëtari i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, Ismajl Ajeti, dhe nga kryetari i Komisionit të Garave për Ligën U17, Ardian Llumnica. Ky sukses i përsëritur tregon angazhimin dhe përkushtimin e trajnerëve dhe stafit të 2 Korriku, por edhe talentin dhe aftësitë e futbollistëve të rinj kryeqytetas.

## Hapet "Java Evropiane e Futbollit", synohet promovimi i futbollit te fëmijët me aftësi të kufizuara

Prishtinë, 25 maj - Të enjten është hapur "Java Evropiane e Futbollit" e cila ka për qëllim nxitjen dhe promovimin e futbollit te fëmijët me aftësi të kufizuara. Lajmin e ka dhënë Ministria e Sportit në rrjetet sociale. "Në kuadër të politikës së gjithëpërfshirës në sport, organizata 'Olimpiada Speciale', në bashkëpunim me Federatën e Futbollit të Kosovës dhe me mbështetjen

e Ministrisë së Sportit, ka hapur javën Evropiane të Futbollit, e cila, ndër qëllimet e veta, ka nxitjen dhe promovimin e futbollit edhe te fëmijët me aftësi të kufizuara", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Sportit. "Gjatë një jave 'Olimpiada speciale' do t'u mundësojë fëmijëve të realizojnë aktivitete të shumta rekreative, futboll e

socializëm mes tyre. Në hapjen që nisi në stadiumin e KF Rilindja në Prishtinë, mori pjesë edhe zëvendësministria Daulina Osmani, e cila u shpreh që MKRS-ja ka në prioritet aktivitete të kësaj natyre që kanë për qëllim promovimin e sportit në përgjithësi, veçanërisht të futbollit te gjeneratat e reja pa përjashtim", thuhet në njoftimin e MKRS-së.



## Inzaghi pas triumfit në Kupë: Na mbeten edhe tri finale deri në fund

Milano, 25 maj - Simone Inzaghi është kthyer në specialist për ta fituar Kupën e Italisë, duke fituar trofeun e tretë me Interin. Më mirë se trajneri zikaltër kanë bërë vetëm Sven Goran Erikson, Massimiliano Allegri e Roberto Mançini, që kanë fituar nga

katër herë këtë kompeticion. Pas ndeshjes Inzaghi nuk e fshehu kënaqësinë për një tjetër trofe të fituar, teksa bëri apel që tashmë vëmendja të kthehet në kampionat e më pas në finalen e Ligës së Kampionëve. "Jam i emocionuar dhe i kënaqur. Donim të rikonfirmoheshim në

këtë kompeticion dhe djemtë u treguan shumë të zotë, ndonëse përballë kishim një Fiorentinë që dha gjithçka. E nisëm keq, por djemtë u rikthyen shpejt në lojë, duke marrë kontrollin e saj. Krijua disa raste dhe arritëm të shënonim dy herë, aq sa në duhej për të fituar. Fillimisht

kemi dy sfida në kampionat, ku na ka mbetur ende një objektivi për të arritur dhe më pas finalja e Ligës së Kampionëve. Do të luajmë të gjitha ndeshjet me përqendrimin maksimal dhe dëshirën për ta marrë maksimumin, ka thënë Inzaghi.



## Iniesta largohet nga Vissel Kobe me lot në sy, por nuk pensionohet

KOBE, 25 MAJ - Andres Iniesta mbërriti në Japoni në vitin 2018 pas largimit nga Barcelona, kurse ka njoftuar me lot në sy se po largohet nga Vissel Kobe "me marrëveshje reciproke" dhe se do të vazhdojë të luajë futboll në një destinacion tjetër. "Mendoj se e kishim imagjinuar gjithmonë se do të tërhiqesha këtu, ishte dëshira e të gjithëve", ka thënë Iniesta, i cili ka përjashtuar mundësinë e tërheqjes nga futbollit dhe e ka bërë të qartë në konferencën për shtyp, se ai me të vërtetë dëshiron të "vazhdojë të luajë" dhe "të vazhdojë të konkurrojë". Mungesa e minutave dhe se "prioritetet e trajnerit (Takayuki Yoshida) janë të ndryshme dhe këtë e respektoj dhe e pranoj" janë arsytet e largimit të lojtarit veteran spanjoll nga Vissel Kobe. Këtë sezon lojtari spanjoll mezi ka luajtur tri ndeshje në J1 League dhe dy në Kupë. Vissel Kobe e falënderoi Iniestën për shërbimet e tij: "Pesë vjet pas nënshkrimit të tij, ne shprehim falënderimet tona më të sinqerta për Andres Iniesta, i cili ka dhënë kontribut të rëndësishëm për ekipin". "Pesë vjet më parë mora një nga vendimet më të



rëndësishme të jetës sime, të largohesha nga Barcelona dhe me familjen time të nisja një aventurë të re larg shtëpisë. Ishte hera e parë që dilnim dhe u respektuam shumë. Duke parë mbrapa ndihem i lumtur dhe krenar që kam marrë atë vendim. Ardhja në Vissel Kobe do të jetë një nga vendimet më të mira që kam marrë në jetën time", ka shtuar Iniesta. "Këtu kam qenë në gjendje të rritem si njeri dhe futbollist. Dhe kam mundur të njoh këtë vend të mrekullueshëm. Në këto pesë vjet kam jetuar momente shumë të bukura dhe të tjera jo shumë. Në këtë rrugë të

gjatë kemi vuajtur momente shumë të vështira, por kjo është ajo që e ka bërë këtë klub të rritet. Gjithmonë e kam imagjinuar se do të pensionohesha këtu, ishte dëshira e të gjithëve. Por, ndonjëherë, gjërat nuk dalin siç i imagjinon dhe rrugët ndahen. Duhet të thuash lamtumirë dhe nuk është e lehtë. Por, nuk është lamtumirë përfundimtare. Marrëdhënia ime me klubin do të vazhdojë ditën që do të pensionohem. Ky klub është shtëpia ime dhe falënderoj Hiroshi Mikitani që respektoi dëshirën time për të vazhduar të luaj", ka përfunduar Iniesta.

## Plani i organizatorëve të Olimpiadës 'Paris 2024', flaka olimpikë në Kullën Eiffel

PARIS, 25 MAJ - Organizatorët e Lojërave Olimpikë "Paris 2024" po përpiqen ta vendosin pishtarin me flakën olimpikë në Kullën Eiffel. Lajmin e konfirmoi për "Reuters" një nga anëtarët e stafit organizator të Olimpiadës që nis pas 15 muajsh në Paris (26 korrik-11 gusht 2024). Burimi shtoi se flaka nuk do të vihej në majë të Kullës Eiffel për arsye teknike dhe nuk është ende e qartë nëse ajo do të qëndronte në monument gjatë gjithë lojërave. Gjithsesi, kombinimi i dy imazheve të tilla ikonike si flaka olimpikë dhe Kulla Eiffel do të ishte një sfond i jashtëzakonshëm. "U bënë gati dy vjet që punojmë për këtë ide. Vendi për ndezjen e flakës në ditën e hapjes së Lojërave



Olimpikë nuk është vendosur ende", tha burimi, që shtoi se flaka nuk mund të qëndrojë në majë të kullës për shkak të antenave të instaluar tashmë atje. Pishtari me flakën olimpikë do të mbërrijë në Francë përmes

qytetit-port të Marsejës më 8 maj 2024. Ajo do të transportohet me anije nga Athina, ku dhe zhvillohet ceremonia e ndezjes së saj, duke udhëtuar për 10 ditë përmes Detit Mesdhe.

### SHKURT

#### Ferrari synon fitoren në Montekarlo, Vasseur: E kemi përgatitur këtë garë

Gara e Montekarlos që zhvillohet këtë javë është një shans i mirë për Ferrarin për ta ndalur hegjemoninë e Red Bullit dhe fituar në një pistë ku konsumi i gomave nuk është problem. Charles Leclerc me "kokëkuqen" ka siguruar dy "pole position" radhazi në dy garat e fundit, por që s'i ka kthyer në fitore. "Do të garojmë në Montekarlo, në shtëpinë e Charles dhe për të është një garë e veçantë. Por edhe për ne. Bashkë me Charles e kemi përgatitur këtë garë në detajet më të vogla, për të shfrytëzuar çdo mundësi që na ofron pista", ka thënë Frederic Vasseur, shef i Ferrarit. "Një pistë qytetare e ngushtë, me pak mundësi parakalimi, por të dy pilotët tanë e duan këtë circuit. Leclerc ka siguruar 'pole' vitet e fundit, ndërsa Sainz ka qenë në podium, pra është një pistë që na përshtatet. Do ta japim maksimumin për të marrë një fitore për t'ua dedikuar tifozëve", ka thënë Vasseur.

#### Reali kërkon Daviesin, Bayerni synon Hernandezin

Real Madridi është vënë në kërkim të një anësori të majtë. Objektivi i tij kryesor për sezonin e ri është Alphonso Davies. Ylli i Bayern Munchenit nuk është emër i padëgjuar në Madrid. Stafi drejtues i Realit ka tentuar edhe më herët ta joshë anësorin kanadez. Sipas "TuttomercatoWeb", nëse Daviesi largohet nga Bayerni, gjigantët gjermanë do të tentojnë t'joshin Theo Hernandez. Anësori i Milanit është vëllai i Lucas Hernandezit, një kartë që Bayerni do ta shfrytëzojë për ta bindur. Futbollisti francez ka shprehur dëshirën e tij për të qëndruar gjatë në Milano, por një ofertë nga Bayerni është gjithnjë tunduese.

#### Unitedi dhe Bayerni në garë për Rabiotin

Adrien Rabiot ka qenë ndër lojtarët e rrallë këtë sezon te Juventusit që ka treguar formë të mirë dhe për shërbimet e tij janë të interesuara disa klube, shkruajnë mediet italiane. Në mesin e tyre Manchester Unitedi dhe Bayern Muncheni, që do të përpiqen ta bindin lojtarin, kontrata e të cilit me Juventusin skadon këtë verë. Klubi italian i ka ofruar kontratë të re mesfushorit francez, megjithatë ky i fundit nuk ka vendosur ende nëse do të vazhdojë në Serinë A apo do të kalojë në Premierë Ligë ose Bundesliga.

#### Reali në bisedime me Robertsonin

Reali i Madridit ka vendosur emrin e mbrojtësit të Liverpoolit, Andrew Robertson, ndërsa po përgatitet për një largim të mundshëm të francezit Ferland Mendy këtë verë. Mbrojtësi i majtë i Liverpoolit ka një kontratë deri në vitin 2026 në "Anfield Road" dhe nuk ka treguar sinjale largimi, por "Daily Mail" raporton se kampionët në dalje të Evropës do të tentojnë me një ofertë 40 milionë paund.

## Dortmundi ngre çmimin e Bellinghamit: Pas titullit vlen më shumë

Te Borussia Dortmundi janë të sigurt se do ta fitojnë titullin kampion, aq sa kanë vendosur të luajnë edhe me çmimin e lojtarëve në merkato. Në qendër të vëmendjes është

mesfushori anglez Jude Bellingham, që do ta lërë Dortmundin, me shumë gjasa për t'u transferuar te Real Madridi. Megjithatë, shefi i klubit gjerman, Sebastian

Kehl, shprehet se deri më tani nuk ka marrë asnjë ofertë zyrtare për 19-vjeçarin britanik. "Asnjë propozim konkret apo zyrtar. Ne jemi fokusuar te ndeshja e së

shtunës për ta fituar titullin. Këtë gjë mendon edhe Jude", ka thënë Kehl. "Të gjithë mendojmë për ndeshjen e fundit dhe fitimin e titullit. Jemi fokusuar te ndeshja ndaj

Mainzit. Nëse fitojmë titullin gjërat ndryshojnë, edhe çmimi i lojtarëve ndryshon. Ka shumë thashetheme për lojtarin, por asnjë ofertë konkrete në tavolinë", u shpreh Kehl.



Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.1695 të datës 25.05.2022, Kryeshefi Ekzekutiv i NPK "Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

### KONKURS I JASHTËM

**Pozita e Punës: Zyrtar për Siguri dhe Shëndet në Punë / Praktikant**

**Numri i pozitave:** 1 (një)

**Kohëzgjatja:** 6 muaj

**Niveli i Pagës:** 50% të pagës

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mbikëqyr implementimin e Ligjit përkatës për Mbrojtje Siguri dhe në Punë si dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore në ndërmarrje;
- Mbikëqyr dhe mbanë përgjegjësi për sigurinë në vendet e punës;
- Përkujdeset për sigurimin e pajisjeve të nevojshme në vendet e punës në bazë të Ligjit për Siguri në Punë;
- Rekomandon ndërmarrjen e masave lidhur me përmirësimin e sigurisë në vendet e punës;
- Monitoron të gjitha mjetet në vende të punës dhe bënë kontroll teknike të vazhdueshme për gjendjen e tyre;
- Përgatit informata dhe planifikon masat e mbrojtjes në punë së bashku me personat përgjegjës të sektorit përkatës dhe me Zyrën Ligjore;
- Monitoron dhe kontrollon implementimin e rregullores për pajisjet mbrojtëse;
- Kontrollon personelin e ndërmarrjes në vende të punës nëse janë të pajisur me pajisjet e nevojshme të obligueshme në vend të punës;
- Organizon trajnime të punëtorëve lidhur me mbrojtjen në punë dhe për këtë mbanë evidencë;
- Në bashkëpunim me departamentet tjera të ndërmarrjes ndikon që të zbatohen masat e mbrojtjes në punë;
- Kujdeset për evidencimin e lëndimeve dhe të sëmundjeve në punë të cilat vijnë si pasojë e kushteve të punës;
- Zbaton procedura për mbrojtje të shëndetit dhe sigurisë në punë që ndërlihen me teknologjinë e punës, organizimin e punës, kushtet, mjedisin dhe marrëdhëniet sociale në ndërmarrje;
- Rekomandon metoda dhe procese të punës të cilat lehtësojnë dhe shmangin punën e njëtrajtshme/monotone me qëllim reduktimin e efekteve negative në shëndetin e punëtorit;
- Është përgjegjës dhe urë lidhëse në mes ndërmarrjes dhe organeve të jashtme Ligjvënëse që ndërlihen me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës;
- Për punët e kryera harton raporte të rregullta, periodike dhe për raste të veçanta;
- Kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, të cilat kërkohen nga Kryeshefi Ekzekutiv;
- Për punën e tij i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

#### Kualifikimet dhe aftësitë:

- Diplomë Universitare
- Aftësi të mira komunikuese dhe të jetë i gatshëm për punë në grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit;

#### 2. Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlihen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

#### Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

#### Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com), Konkursi është i hapur nga data 26.05.2023 dhe përfundon më datë 02.06.2023 deri në ora 24:00.

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data:  
26.05.2023

NPK "Trafiku Urban" SH.A  
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë  
web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com) email: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com) tel: +383 45 10 11 33



U prilog članu 8 Zakona o radu br. 03/L-212, Republike Kosovo, član 4 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a), član 10 tačka 1 i 5 i član 11 tačka 1 Uredbe br. 1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima i Uredba br.01/2022 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta br. 1827 od 13.07.2022.godine, kao i Odlukom br.1695 od 25.05.2022.godine, Izvršni direktor NPK „Trafiku Urban“ SH, Priština, objavljuje:

### JAVNI KONKURS

**Radno mesto:** Službenik za bezbednost i zdravlje na radu / praktican rad

**Broj pozicija:** 1 (jedan)

**Trajanje:** 6 meseci

#### Dužnosti i odgovornosti:

- Nadzire sprovođenje relevantnog Zakona o bezbednosti i zaštiti na radu kao i drugih zakonskih i podzakonskih akata u preduzeću;
- Adgledati i preuzeti odgovornost za bezbednost na radnim mestima;
- stara se o obezbeđivanju potrebne opreme na radnim mestima na osnovu Zakona o zaštiti na radu;
- Preporučuje preduzimanje mera koje se odnose na unapređenje bezbednosti na radnim mestima;
- Nadgleda sve alate na radnim mestima i vrši stalne tehničke provere njihovog stanja;
- iprema informacije i planira mere zaštite na radu zajedno sa odgovornim licima resornog sektora i pravnom kancelarijom;
- Prati i kontroliše sprovođenje propisa o zaštitnoj opremi;
- overava osoblje preduzeća na radnim mestima da li je opremljeno potrebnom obaveznom opremom na radnom mestu;
- rganizuje obuku radnika u vezi sa zaštitom na radu i vodi evidenciju o tome;
- saradnji sa drugim službama preduzeća utiče na sprovođenje mera zaštite na radu;
- rine se za identifikaciju povreda i oboljenja na radu koja su posledica uslova rada;
- provodi postupke zaštite zdravlja i bezbednosti na radu koji se odnose na tehnologiju rada, organizaciju rada, uslove, životnu sredinu i društvene odnose u preduzeću;
- preporučuje metode i procese rada koji olakšavaju i izbegavaju jednoličan/monoton rad u cilju smanjenja negativnih efekata na zdravlje radnika;
- dgovoran je i predstavlja most između kompanije i spoljnih zakonodavnih tela koja se odnose na bezbednost i zdravlje na radnom mestu;
- Priprema redovne, periodične i posebne izveštaje o obavljenom poslu;
- bavlja poslove i druge poslove u vezi sa opisom poslova koje zahteva izvršni direktor;
- dgovoran je za svoj rad glavnom izvršnom direktoru.

#### Kvalifikacije i veštine:

- akultetska diploma
- obre komunikacijske veštine i spremnost za rad u grupi;
- Da se protiv podnosioca prijave ne vodi krivični postupak;

#### 2. Potrebna dokumentacija:

- Prijava za zapošljavanje (preuzmite sa sajta TU <https://vvv.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
- okaz o obrazovanju;
- Kopija lične karte;
- okaz o radnom iskustvu
- okaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;
- opije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurirate su prednost;

-Svako falsifikovanje materijala, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

#### Opšte informacije:

- Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.
- Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angazovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.
- Pismeni test i intervju biće obavljani nakon isteka roka za prijavu u skladu sa zakonom.

#### Način primene:

Prijava se može izvršiti samo putem mejla: [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com), Konkurs je otvoren od 26.05.2023 i završava se 02.06.2023 do ponoći.

Napomena: Nepotpuna dokumenta i dokumenti koji pristignu nakon konkursnog roka neće se razmatrati.

Datum: 26.05.2023

NPK "Trafiku Urban" SH.A  
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë  
web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com) email: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com) tel: +383 45 10 11 33



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mirlinda Fetahu nga Prishtina, shpall të pavlefshme dëftesat, certifikatën e notave dhe diplomën e lëshuar nga shkolla e mesme Sh.M.T.H.T "7 Shatori", Prishtinë.

- Albin Ahmeti shpall te pavlefshme dëftesat 6 deri 9 te shkollës fillore "Migjeni".

- Besmir Haxhikadrija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl.I,II,III,IV dhe diplomën e shm.m. Ekonomike " Kadri Kusari. Gjakovë.

- Myrvete Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë " Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Nexhat Xhemaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

- Gentiana Gashi shpall te pavlefshme dëftesat , certifikatën , diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Andi Haxhiu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Sadri Berisha nga Lipoveci KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. Shaban Gola" nga kl. I-V dhe VI-IX Lipovec.

- Alban Miftari nga Gjkova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Vildane Braha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Tekstil.

- Astrit Duraku shpall të pavlefshme dëftesat, diplomën si dhe certifikatën e maturës të shkollës "Hoxhë Kadri Prishtina" Prishtinë.

- N.T.SH "FIBELLO" Shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 810558330.

- N.T.SH "FIBELLO" shpall te pavlefshme certifikatën e TVSH-SE me numër 330217564.

- N.T.SH "FIBELLO" shpall te pavlefshme certifikatën e numrit fiskal me numër "600694732.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

